



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## **KËSHILLI I QARKUT SHKODËR**

### **SHPLLJE PËRLËVIZJEPARALELE NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar si dhe pikat 5 dhe 6 të kreut II, e III të VKM-ja nr 242 datë 18.03.2015 “Për plotesimin e vëndeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, VKM-në Nr. 421 datë 26.06.2024 Këshilli i Qarkut Shkodër shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë në shërbimin civil për pozicionin:

**Drejtor në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës**

**Këshilli të Qarkut Shkodër**

**Klasa e pages : III-1**

**Për të dy procedurat lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë!**

<b>Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE :</b>	<b>21.11.2024</b>
<b>Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË :</b>	<b>26.11.2024</b>

## **Përshkrimi përgjithësues ipunës për pozicionin e mësipërmështë:**

- Përfaqëson Drejtorinë në të gjitha marrdhëniet e saj me Drejtoritë në Këshilline Qarkut Shkodër, institucionet e ndryshme si dhe me të gjitha organet shtetërore, vendore për problemet që ka kjo drejtori në kompetencë.
- Drejtori i DAMT-së përgjigjet para Këshillit të Qarkut dhe strukturave përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- DAMT-ja përgjigjet për zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e tokës bujqësore, si dhe të kategorive të tjera të resurseve të përcaktuara në Ligjin Nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore për administrimin e tokës.
- Ndan funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të DAMT-së.
- Drejtori i DAMT-së organizon punën dhe përgjigjet për kualifikimin tekniko-profesional të punonjësve të DAMT-së nëpërmjet trajnimeve periodike të tyre dhe informimeve për standardet bashkëkohore, në fushën e administrimit dhe mbrojtjes së tokës.
- Drejtori i DAMT-së, për realizim e funksionit të saj si kadastër e shumëqëllimshme, mban dhe ruan, me inventarizim, dokumentacionin kadastral ekzistues që disponohet pranë saj, pavarësisht nga koha e krijimit të tij.
- DAMT-ja bashkërendon veprimtarinë me Zyrën e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT) në Njësi Administrative dhe/ose bashki, organizon punën për krijimin e dokumentacionit të ri kadastral përtokën bujqësore dhe kategoritë e resurseve të tjera, të përcaktuara me ligj.
- DAMT-ja bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për këmbimin e informacioneve, të treguesve dhe të të dhënave, që krijohen nga zbatimi i programeve dhe projekteve me objekt tokën bujqësore dhe disa kategori të resurseve të tjera.
- Bazuar në dokumentacionin, aktet, treguesit dhe informacione e marra nga institucionet kompetente, si dhe sipas informacioneve dhe të dhënave plotësuese, që disponohen dhe krijohen nga veprimtaria e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, në Fushë-Krujë, e institucioneve të tjera shtetërore, organizon punën për krijimin e Sistemit të Informacionit për Tokën dhe integrimin gradual të tij në GIS, për të gjitha resurset që ka në administrim, brenda territorit të qarkut.
- Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga ligji.

- **LEVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurëvetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

- **KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-1 (Bazuar në VKM Nr. 421, datë26.06.2024, lidhja Nr.1 e lidhja 12);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë tëpaktën vlerësimin e fundit “mirë” ose “shumë mirë”;

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

- Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkencat, Gjeodet. Agronom Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion, nga të cilat 1 (një) vit në nivel të mesëm drejtues.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

- **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

**Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- Jetëshkrim i plotësuar në perputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

- Fotokopje të diplomës e noterizuar (përfshirë edhe diplomën Bachelor). (*Diplomat të cilat*

*janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi);*

- Fotokopje të librezës së punës e noterizuar (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes gjygjësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjygjësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtëpërsëdrejti në institucion, brënda datës 21.11.2024, në adresë: Këshilli i Qarkut Shkodër, Zyra e Burimeve Njerëzore, Rr. 28 Nëntori, Shkodër.***

#### **• REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Pas dates 21.11.2024, Këshilli Qarkut Shkodër do të shpalli në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Keshillit të Qarkut Shkodër, listën e kandidatëve që plotesojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vëndin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotesojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Shkodër, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifimit.

#### **• FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSIVE DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË**

## ZHILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen nëlidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën publike”;
- Ligjin Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Përparandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
- Ligjin Nr. 8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave përadministrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 121 date 17.02.2011 “Për menyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”;
- VKM Nr. 410 datë 02.07.2012, i ndryshuar, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive tëresurseve të tokës”;
- VKM Nr. 45/2014 “Për kalimin në administrin të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave...”;
- Ligjin Nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 80 datë 21.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore”;
- Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- VKM Nr. 502, DATË 13.7.2011, “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 20/2020, (datë 05.03.2020) “Për përfundimin eproceseve kalimtare të

pronësisën Republikën e Shqipërisë”;

- VKM Nr. 1181, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të krijimit, përdorimit, administrimit, ruajtjes dhe ndërveprimit të bazës së të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë”;
- VKM Nr.1174, datë 24.12.2020, “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin ekufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqetshtetërore shtesë e pronat shërbyese”;
- VKM Nr. 994, datë 09.12.2015 “Për proçdurën e regjistrimit të AMTP-ve”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”;
- Ligjin Nr. 111/2018 “Kadastrën”;
- VKM Nr. 864, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave për procedurën e trajtimit të kërkesave për shërbime kadastrale”;
- VKM Nr.782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 605, datë 29.7.2020 “Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive natyrore”;
- VKM Nr. 4, datë 11.1.2023 “Për rregullat e hollësishme, mënyrat dhe mjetet tekniko-hartografike për përmirësimin e regjistrit kadastral”;
- VKM Nr. 867, datë 10.12.2014, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar.

#### • **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

- **40 Pikë** për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- **60 Pikë** intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2 date 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

- **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Keshilli i Qarkut Shkodër do të shpallë fituesin në portalin “Sherbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Shkodër. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

- **NGRITJA NË DETYRË**

- Vetëm në rast se pozicioni I renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës se lëvizjes paralele rezulton se është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.
- Këtë informaciondo ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Shkodër.
- **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civil të një kategorie parardhëse (vetëm një kategori më ulët), të punësuar në të njëjtin apo në institucione të tjera të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritje në detyrë të cilët plotësojnë kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (nëpunësi civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, kategoria III-2 (Bazuar në VKM Nr. 421, datë 26.06.2024, lidhja Nr.1 e lidhja 12);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:**

- Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master Shkencor” në shkencat, Gjeodet, Agronom. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*);
- Të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në profesion nga të cilat 1 (nje) vit në nivel të ulët drejtues;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

## **• DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës e noterizuar (përfshirë edhe diplomën Bachelor). (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*);



- Fotokopje të librezës së punës e noterizuar (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes gjygjësore;
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjygjësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin jetëshkrimin tuaj;

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtëpërsëdrejti në institucion, brënda datës 26.11.2024, në adresë: Këshilli i Qarkut Shkodër, Zyra e Burimeve Njerëzore, Rr. 28 Nëntori, Shkodër.***

- **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Pas dates 26.11..2024, Këshilli Qarkut Shkodër do të shpalli në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Keshillit të Qarkut Shkodër, listën e kandidatëve që plotesojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë do të njoftohen individualisht,kandidatët që nuk i plotesojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe për shkaqet e moskualifikimit, në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Shkodër, (nëpërmjet adresës së e-mail).

- **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSIVE DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën publike”;
- Ligjin Nr. 9367 datë 07.04.2005 “Përparandalimin e konfliktit të interesave në

ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar;

- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin Nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”;
- Ligjin Nr. 8752 datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave përadministrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 121 date 17.02.2011 “Për menyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”;
- VKM Nr. 410 datë 02.07.2012, i ndryshuar, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive tëresurseve të tokës”;
- VKM Nr. 45/2014 “Për kalimin në administrin të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish-institucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave...”;
- Ligjin Nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 80 datë 21.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore”;
- Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- VKM Nr. 502, DATË 13.7.2011, “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 20/2020, (datë 05.03.2020) “Për përfundimin eproceseve kalimtare të pronësisën Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 994, datë 09.12.2015 “Për proçdurën e rregjistrimit të AMTP-ve”, i ndryshuar;
- VKM Nr.1174, datë 24.12.2020, “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin ekufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqetshtetërore shtesë e pronat shërbyese”;
- VKM Nr. 1181, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të krijimit,

përdorimit, administrimit, ruajtjes dhe ndërveprimit të bazës së të dhënave të proceseve kalimtare të pronësisë”;

- VKM Nr. 1182, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore”;
- Ligjin Nr. 111/2018 “Kadastrën”;
- VKM Nr. 864, datë 27.12.2022, “Për miratimin e rregullave për procedurën e trajtimit të kërkesave për shërbime kadastrale”;
- VKM Nr.782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 605, datë 29.7.2020 “Për regjistrimin e pemëve dhe të pasurive natyrore”;
- VKM Nr. 4, datë 11.1.2023 “Për rregullat e hollësishme, mënyrat dhe mjetet tekniko-hartografike për përmirësimin e regjistrit kadastral”;
- VKM Nr. 867, datë 10.12.2014, “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

- **MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- Deri në **20 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar;
- Deri në **40 pikë** për vlerësimin meshkrim;
- Deri në **40 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2 datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[www.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”.

- **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Shkodër do të shpallë fituesin në portalin “Sherbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Shkodër. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe për shpalljen e fituesit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Qarkut Shkodër, për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Shkodër duke filluar nga data 27.11.2024.